

Emri i Seminarit

Arti dhe Arkitektura

Ligjëruese e Seminarit:

Brunilda Basha – Pedagoge, Kordinatore Departamenti, Universiteti Barleti

Përmbledhja e Seminarit:

Studimi i historisë së Artit dhe Arkitekturës është një lëmi e gjerë e cila përfshin zhvillimin e mjedisit urban arkitekturor dhe estetik në periudha të ndryshme historike, duke filluar nga ai antik dhe duke vazhduar deri në kohën bashkëkohore. Nëpërmjet leksioneve dhe temave të shqyrtuara do të kuptohet më mirë fuqia që ka patur arti dhe arkitektura në perspektivën historike. Ky seminar ka për qëllim të diskutojë dhe analizojë veprën e artit dhe disiplinën e arkitekturës botërore (përfshi atë perëndimore dhe lindore) duke eksploruar veprat dhe objektet që kanë luajtur një rol të rëndësishëm në atë periudhë kohore si në aspektin shoqëroro- kulturor, politik apo ekonomik. Njëkohësisht sëbashku me etapat dhe filozofinë e periudhave arkitekturore studentet do të njihen me artistët dhe arkitektët e kohës të cilët kanë patur një ndikim të rëndësishëm në fushën e artit.

Syllabus:

Java e I: HYRJE:

- Cfarë nenkuptojmë me histori të artit dhe arkitekturës.
- Pse studimi i historisë është e rëndësishme
- Kronologjia e etapave të historisë botërore
- Hyrje në periudhën Antike

JAVA E II: ZHVILLIMI I ARTIT DHE ARKITEKTURES NE PERIUDHEN ANTIKE DHE ATË MESJETARE EUROPIANE

A: Mesopotamia, Egjipti, Greket, Romaket

B: Romanesk, Gotik, Barok, Renaissance, Art Deco

- *Brunelleschi, Donatello, Michelangelo*

JAVA E III: ARKITEKTURA DHE ZHVILLIMI I SAJ GJATË SHEKULLIT 19-TË DHE 20-TË.

- Zhvillimi industrial i shek. 19 dhe influencat e tij
- Teoritë dhe filozofia e arkitektures Moderne
- Koncepti i Bauhaus; Walter Gropius, Mies van der Rohe, Le Corbusier, Loius Sullivan, Frank Lyod Wright

Java e IV: ARTI DHE ARKITEKTURA ISLAME

- Lindja dhe shtrirja e saj
- Filozofia dhe parimet zhvilluese
- Përbërësit Morfologjikë të Qytetit Islamik
- Elementet estetike të dekorimit islam

Literaturë themelore:

- Fletcher, B. (1996). A History of Architecture. 20th Edition. Architectural Press.
- Hillenbrand, R., (1998), “Islamic art and architecture”, London: Thames and Hudson
- Summerson, J. (1980). The Classical Language of Architecture of Architecture. London. Thames and Hudson
- Burckhardt, T., (2009), “Art of Islam, Language and Meaning”, Commemorative Edition, World Wisdom

Literaturë shitesë

- Breitling, S, Dorner, E., Dreher, A., (1996). The Story of Architecture, From Antiquity to the Present. Koln. Konemann.
- Christian, N. S. (1980). Meaning in Western Architecture. New York. Rizzoli.
- Summerson, J. (1980). The Classical Language of Architecture of Architecture. London. Thames and Hudson
- John Freely, 2011, “A history of Ottoman Architecture”, WIT Press, Boston
- Jeanan Shafiq, 2014, “Architectural Elements in Islamic Ornamentation: New Vision in Contemporary Islamic Art,” Arts and Design Studies, Vol. 21
- Oleg Grabar, (1973), “The Formation of Islamic Art”, Yale University Press
- Valérie Gonzalez, 2001, “Beauty and Islam. Aesthetics in Islamic Art and Architecture.”, I.B.Tauris Publishers, London

Emri i Seminarit

Shteti, Shoqëria dhe Politika

Ligjërues i Seminarit:

Doc. Dr. Drita Memeti - Universiteti I Tetovës

Përmbledhja e Seminarit:

Temat që do të shtjellohen gjatë realizimit të këtij seminari qëndrojnë në raport të ndërlidhur njëra me tjetrën me qëllim që të arrihet një qasje e përgjithshme mbi krijimin e shtetit dhe rolin e tij në shoqëri. Fillimisht do të trajtohen pikëpamjet mbi shtetin të ndara nëpër periudha të ndryshme kohore për të kaluar pastaj në problematikat konkrete socio-politike të cilat u përkasin qytetarëve të Maqedonisë së Veriut, si për shembull : Kultura politike në vendin tonë, roli i shoqërisë civile në vendimmarrje në Maqedoninë e Veriut si dhe politikat aktuale në vend.

Syllabus:

Java e I: KRIJIMI I SHTETIT

- Mendimi politik gjatë historisë
- Pikëpamjet antike mbi shtetin
- Mendimi politik gjatë Perandorisë Romake
- Koncepti i shtetit në mesjetë
- Pikëpamjet politike të kohës së re

Lexim i detyrueshëm

Politika dhe Politikat Publike, Tetovë, 2011, fq. 11-17

Java e II: SHTETI DHE POLITIKA

- Pushteti
- Ideologjitë politike
- Grupet e interesit
- Partitë politike

Lexim i detyrueshëm

• Jean-Marie Denquin, Hyrje në shkencat politike, UET/Press, fq.08-18

Java e III: FORMAT E QEVERISJES DHE NDIKIMI I TYRE NË SHOQËRI

- Monarkia
- Aristokracia
- Oligarkia
- Demokracia, etj.

Lexim i detyrueshëm

• Andrew Heywood, Politika, Dukagjini, 2008, fq. 23-100

Java e IV: KULTURA POLITIKE

- Komunikimi politik
- Gjuha e urrejtjes
- Konfliktet shoqërore

Lexim i detyrueshëm

• FES, Menaxhmenti Politik, Shkup, 2009, fq.164-289

Java e V: SHOQËRIA CIVILE DHE ROLI I SAJ NË VENDIMARRJE NË MAQEDONIN E VERIUT

- Shoqëria civile dhe mobilizimi i komuniteteve
- Rëndësia e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje
- Roli i Shoqërive civile në integrimin e vendit në BE
- Sektori qytetar-si punëdhënës i padukshëm
- Sektori qytetar- si korigjues i pushtetit
-

Lexim i detyrueshëm

- Dejan Donev, Nevladiniot sector kako eticki korektiv na opstestvoto, MCMS, 2008, Shkup

Java e VI: POLITIKA AKTUALE NË VENDIN TONË

- Politikat publike
- Vendimmarrja
- Fushata zgjedhore
- Njësitë zgjedhore
- Përfaqësimi i drejtë

Lexim i detyrueshëm

- Etem Aziri – Sistemet Politike, Tetovë, 2017, fq..173-31

Literaturë themelore:

Jonuz Abdullahi, Politika dhe Politikat Publike, Tetovë, 2011

Jean-Marie Denquin, Hyrje në shkencat politike, UET/Press, 2011

Andrew Heywood, Politika, Dukagjini, 2008

FES, Menaxhmenti Politik, Shkup, 2009

Dejan Donev, Nevladiniot sector kako eticki korektiv na opstestvoto, MCMS, 2008, Shkup

Etem Aziri – Sistemet Politike, Tetovë, 2017

Literaturë shtesë

Brian McNair, Hyrje në Komunikimin Politik, UET/Press,
2009

Manfred G.Schmidt, Teoritë dhe modelet e demokracisë,
Botart, Tiranë, 2012

J.J. Chevallier, Y.Guchet, Veprat e mëdha politike, Liria,
Tiranë, 2001

Joe Marconi, Marrëdhëniet publike, UETPress, 2010

Emri i seminarit

Ekonomia dhe Menaxhmenti

Ligjërues i seminarit

Assist. Prof. Dr. Bujamin Bela – Universiteti “Nënë Tereza” në Shkup

Përshkrimi i seminarit

Struktura e programit përmban ligjërata që nga natyra ofrojnë një qasje integrale në tema të biznesit (menaxhmentit) dhe ekonomisë.

Qëllimi i këtij seminari është që studentët që njoftohen dhe t’i kuptojnë mjedisin e biznesit, bazat e menaxhmentit, subjektet e biznesit dhe operacionet e tyre në kontekstin e menaxhimit strategjik, menaxhimit të projektit, burimet njerëzore, menaxhimin e përgjithshëm të cilësisë dhe menaxhimin e investimeve; si dhe me parimet themelore në të cilat do të bazohet puna e secilit menaxher të ardhshëm. Ndjekja e këtij seminari ka për qëllim që studentët të përfitojnë njohuri themelore nga fusha e funksioneve bazike në menaxhment si planifikimi, organizimi, koordinimi, motivi dhe kontrolli. Ndjekja e seminarit **EKONOMIA dhe MENAXHMENTI** pjesmarrësve do t’u mundësojë:

- T’i shpjegojnë problemet fundamentale ekonomike.
- T’i kuptojnë lidhjen kohezive midis makroekonomisë dhe mikroekonomisë.
- T’i diskutojnë qëllimet dhe instrumentet e makroekonomisë.
- Të kuptojnë dhe t’i sqarojnë ciklet ekonomike.
- Të mësojnë bazat e menaxhmentit, aftësitë dhe rolet menaxheriale dhe të aftësohen për to që të japin shembuj konkretë.
- Të aftësohen ta shohin këtë seminar si nevojë për fitimin e njohurive menaxheriale, të cilat do të jenë në kontekst të zbatimit në praktikë të asaj që kanë mësuar.
- Të mendojnë në mënyrë efektive që do t’u ndihmojë të përballen me problemet afariste në jetën e tyre të mëtejshme.
- Të zhvillohet koncepti i të menduarit kritik.
- T’i përgatisë pjesmarrësit për pozitën e udhëheqësit në organizatat profitabile dhe jofitimprurëse.

Literatura

1. Riki V. Griffin, Bazat e menaxhmentit, Geneks – Përkthime, Koçan
2. Gregory Mankiw, Principet ekonomike, - Geneks – Përkthime, Koçan
3. Ricard.L.Daft, Menaxhment - Geneks – Përkthime, Koçan
4. Izet Zeqiri, Bazat e menaxhmentit, Tetov, 2016
5. Anne Lawrence dhe James Weber, Biznesi dhe Shoqëria, 2008, USA
6. Besim Beqaj, BIZNESI NDËRKOMBËTAR, Universiteti i Prishtinës Fakulteti Ekonomik, 2015
7. Halil Kukaj, Biznesi Ndërkombëtar, Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren, Prizren, 2017.
8. Bolander dhe Snell, Menaxhimi me resurset njerzore, GENEKS Përkthime, - Koçan (në shqip dhe maqedonisht) 2011